VENDIM
Nr.615, datë 21.12.1999

PËR MIRATIMIN, NË PARIM, TË PROJEKTIT "INICIATIVË E EMERGJENCËS ME QËLLIM RIBËRJEN E SHËRBIMEVE ESENCIALE DHE TË DOBISË PUBLIKE NË QYTETIN E VLORËS"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 7, të ligjit 8371, datë 9.7.1998, "Për lidhjen e traktateve dhe amrrëveshjeve ndërkombëtare", me propozimin e Ministrisë së Punëve Publike Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1.Miratimin, në parim të projektit "Iniciativë e emergjencës me qëllim ribërjen e shërbimeve esenciale dhe të dobisë publike në qytetin e Vlorës", për shumën prej 1 miliard liretash, dhënë në formë granti nga qeveria italiane.

2.Miratimin, në parim, të kontributit të qeverisë së Republikës së Shqipërisë në projekt, si kosto lokale etj, për përballimin e taksave doganore dhe të detyrimeve të tjera fiskale për vitin 2000.

3.Ngarkohen Ministria e Punëve Publike dhe bashkia e Vlorës për ndjekjen dhe zbatimin e këtij projekti.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta